



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 289/ 7 prot.

Datë 20 .02.2024

V E N D I M

Nr. 195 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20 .02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.146/2024, datë 06.02.2024, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82665-10-06-2023, me objekt: “*Prodhim, publikim dhe botim i materialeve për fushata promovionale*” me fond limit 1,684,360 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.10.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, me Nipt. L52122014L
Adresa: Rr. “Siri Kodra”, Ish blloku i magazinave, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Lulzim Mehmetaj” P.F me Nipt L36702001T. *Adresa: Rr. Gjovalin Gjadri, zona kadastrale nr.8593, nr. pasurie 13/264, Shkodër.*

Baza Ligjore: Ligji Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 06.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.146/2024 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga “Inpress” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-82665-10-06-2023, me objekt: “Prodhim, publikim, dhe botim i materialeve për fushata promovionale”, me fond limit 1,684,360 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
2. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit në lidhje me vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” SHPK sipas konstatimeve të këtij vendimi.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi të verë në dijeni KPP-në mbi zbatimin e tij.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 3129 prot., datë 14.02.2024, protokolluar me tonën nr. 289/4 prot., datë 19.02.2024 me objekt “Zbatim vendimi” autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër, informon se ka zbatuar vendimin Nr.146/2024, datë 06.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 3129 prot., datë 14.02.2024, protokolluar me tonën nr. 289/4 prot., datë 19.02.2024 me objekt “Zbatim vendimi” autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër, informon se ka zbatuar vendimin Nr.146/2024, datë 06.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-82665-10-06-2023, me objekt: “Prodhim, publikim, dhe botim i materialeve për fushata promovionale”, me fond limit 1,684,360 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Referuar shkresës sipërcituar autoriteti kontraktor informon se ka kryer rivlerësim të ofertave më datë 14.02.2024 sipas konstatimeve të vendimit të KPP-së.

II.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Komisioni konstatoi se autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër ka zbatuar vendimin Nr.146/2024, datë 06.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik duke kryer rivlerësim të ofertave për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapa të mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-82665-10-06-2023, me objekt: “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve për fushata promovionale”, me fond limit 1,684,360 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro